**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERËVE TIRANË**
**NR. 4381 REP**
**NR. 1873 KOL**

**VENDIM**

**I**

**ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE**

Më datë 07/11/2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë), përpara meje noterit Edlira Malaj anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli Rr. "D. Frasheri" Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së përgjithshme të Ortakëve te Shoqerise Tregetare EVITA shpk me Nipt L31714005J, ("Shoqeria"), kapitali i se ciles eshte 30.100.000,00 Leke (tridhjete milion e njëqind mije), te ndare ne 2 (dy) kuota te cilat perbejne 72.50% dhe 27.50% te kapitalit, ne perputhje me kerkesat e ligjit dhe statutit te Shoqerise u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, me rendin e ditës si më poshtë:

1. Miratimin e transferimit nëpërmjet shitjes, së 1 kuote te Shoqerise me vlerë nominale 21.822.500,00 Leke (njezet e nje milion e teteqind e njezet e dy mije e peseqind) e cila perben 72.5 % të kapitalit themeltar ("Kuota"), nga zotëruesi i saj ortaku i Shoqërisë Z. [redacted] tek blerësi ARIMO B.V., nje shoqeri me përgjegjësi te kufizuar, e organizuar dhe qe ekziston sipas legjislacionit te Holandës, me seli ne adresen: Paasheuvelweg 16, 1TO5BH Amsterdam, me numer regjistrimi 63531100.

2. Miratimin e Kontratës së Shitjes së Kuotave, që do të lidhet ndërmjet palëve: Z. [redacted] në cilësinë e shitësit dhe shoqërisë ARIMO B.V. në cilësinë e blerësit.

3. Të ndryshme.

[Shqiptarja.com]